


01-1932



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-247269/22 dt. 10.11.2022, të kërkuarit / subjektit juridik “Parking Center” Sh.p.k. certifikatë të regjistrimit ARBK 811346825, rruga “Ismail Qemali” numër 17, Prishtinë (shfrytëzues për 35 vite) për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesë me garazha nëntokësore - “Parking nëntokësor, te Fakulteti Filologjik” në Prishtinë me etazhitet -2B/dy nivele nëntokësore, (sipas kontratës PPP), ndërtuar në kuadër të parcelës ndërtimore “Z12” Planit Rregullues “Qendra 2”, në Prishtinë dhe PZHU-së, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 03.04.2023, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuarit / subjektit juridik “Parking Center” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811346825, me pronar Korab Fazliu, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-247269/22 dt. 10.11.2022, përdorimi i kompleksit me ndërtesë me garazha nëntokësore - “Parking nëntokësor, te Fakulteti Filologjik në Prishtinë” me etazhitet -2B/dy nivele nëntokësore, (sipas kontratës PPP), të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-41156/20 dt. 23.09.2020 dhe Vendimit 05 Nr. 351/02-41156/20 dt.04.11.2021 mbi plotësim ndryshimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, në kuadër të parcelës ndërtimore “Z12” Planit Rregullues “Qendra 2” dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7090-22, ZK Prishtinë, me pronar/posedues P.Sh. KK Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Xhorxh Bush” dhe “Eqrem Çabej” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 5, 61, 63, 65 dhe 69 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## Ar sy e t i m

Kërkuesi / subjektit juridik "Parking Center" Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811346825, me pronar Gazmend Haxholli, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-247269/22 dt. 10.11.2022, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksit me ndërtesë me garazha nëntokësore - "Parking nëntokësor, te Fakulteti Filologjik në Prishtinë" me etazhitet -2B/dy nivele nëntokësore, (sipas kontratës PPP), të ndërtuara në kuadër të parcelës ndërtimore "Z12" Planit Rregullues "Qendra 2" dhe PZHU-së, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7090-22, ZK Prishtinë, me pronar/posedues P.Sh. KK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-41156/20 dt. 23.09.2020 dhe Vendimit 05 Nr. 351/02-41156/20 dt.04.11.2021 mbi plotësim ndryshimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Njoftim lidhur me kërkesën për inspektim final", me referencë 09 Nr. 391/02-237292/22 dt. 09.11.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Avni Ranadani; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Adnan Bekteshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Besim Abrashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Qani Nuhiu; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Xhevdet Gashi, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar "GeoService Engineering Group" Sh.p.k. për matje gjeodezike;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa garazhuese me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e

certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa garazhuese me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat garazhuese me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-247269/22 DT. 03.04.2023**

Zyrtari,  
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



Drejtori,  
Arber Sadiki

